



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:270285

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874776

KPPP.nr.2086/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” SH.A., me NUI:811292979, me seli Prishtinë, rruga “Sylejman Vokshi”, kundër debitorit “Horeca” L.L.C., me NUI: 810844515, me seli në Prishtinë, rruga “Ndue Përlleshi”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Ahmet Tahiri, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.1857/23 të datës 15.11.2023, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. “Horeca” L.L.C., i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.1857/23 të datës 15.11.2023, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbarimor P.nr.1857/23 i datës 15.11.2023, i Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbaruesit Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.1857/23 të datës 15.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarimore - Marrëveshja mbi Pengun Nr.178/20 e datës 11.08.2020, Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20200921-407 i datës 21.09.2020, duke detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin t’ia paguaj kreditorit shumën prej 15,587.07 €, me kamat referente si pjesë e kamatës ligjore, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë

e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, në të kundërtën realizimi i përbarimit të bëhet përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë për debitorët deri në realizimin e vlerës së borxhit, nëse debitorët nuk kanë mjete në llogaritë bankare atëherë përbarimi të realizohet përmes sekuestrimit të kolateralit të cilin debitori e ka lënë peng.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se urdhri përbarimor përkatësisht përbarimi në këtë çështje është lejuar pa ndonjë dokument përbarimor të përcaktuar sipas LPP-së, por vetëm në bazë të një marrëveshje tashmë të ekzekutuar të pengut në shumë prej 15,584.07 €. Tutje ka shtuar se debitori nuk ka pasur për qëllim dhe nuk ka dashur që t'i ikë përmbushjes së obligimeve ndaj kreditorit, mirëpo kjo marrëveshje tashmë është ekzekutuar për faktin se kreditori ka marrë gjësende të tjera të cilat kanë qenë në depon doganore duke realizuar kështu kërkesën e tij. I ka propozuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përbarimor si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se i kundërshton në tërësi të gjitha pretendimet e debitorit duke theksuar se kreditori në cilësinë e siguruesit, përmes polices numër 0604800100847852 me datë të lëshimit 02.08.2022, ka bërë sigurimin e përmbushjes së detyrimit me vlerë të sigurimit 50,000.00 €, në emër të debitorit, ku si rezultat i mos zbatimit të kontratës ka paguar shumën prej 15,584.07 €. Tutje ka theksuar se pas kësaj kreditori i ka lindur e drejta e regresit të borxhit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përbarues dhe i përmban të gjitha

elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin përmbarues përkatësisht Marrëveshjen mbi Pengun Nr.178/20 të datës 11.08.2020, e regjistruar në zyrën për regjistrim të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengun R-20200921-407 të datës 21.09.2020, e cila i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, pasi që Marrëveshja mbi Pengun Nr.178/20 e datës 11.08.2020, është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengun R-20200921-407 të datës 21.09.2020, si dhe e njëjta është paraqitur në origjinal.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2086/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.